

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Marte datë 16 Qershor 2020 ora 12:00 do të zhvillohet online (me anën e komunikimit elektronik të njëkohshëm) mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panënshkruara të emetuara me Vendimin nr. 04/3, datë 01.10.2019 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a..
2. Propozim për riemërimin e shoqërisë "Grant Thornton Albania" si ekspert kontabël i autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2020.
3. Propozim për zgjerimin dhe hapjen e limiteve të linjave të kredive në valute me të gjitha institucionet financiare, me të cilat Banka Credins ka investime në obligacione në monedhe të huaj.
4. Propozim për dhënien e bonusit për Drejtorinë në masën 1% dhe për anetaret e Keshillit Drejtues në masën 0.5% të rezultatit financiar të vitit ushtrimor 2019 sipas BOA.
5. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si më poshtë:
 - 1) Mbi miratimin e riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, për periudhën 3-vjeçare nga data 24.07.2020 deri në datën 24.07.2023, konkretisht:
 - Znj. Estela Koci
 - Znj. Vjosa Bodo
 - Z. Eugen Nuri
 - 2) Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare për vitin financiar që mbyllet me 31.12.2020.
 - 3) Mbi miratimin e tekstit të kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 - 4) Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

6. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet perkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Falënderit

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë me 26.05.2020

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrëjë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.